

Neni 162

Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen nënkrerët tariforë për zbatimin e pikës 1, të nenit 161.

Neni 163

Zhdoganimi i centralizuar

1. Autoritetet doganore, kundrejt një aplikimi, mund të autorizojnë një person të depozitojë, në zyrën doganore përgjegjëse për vendin ku është vendosur personi, një deklaratë doganore për mallrat, të cilat janë paraqitur në një zyrë tjetër doganore.

Kërkesa për autorizim nuk kërkohet kur deklaratata doganore është depozituar dhe mallrat paraqiten në zyrën doganore nën përgjegjësinë e një autoriteti të vetëm doganor.

2. Aplikuesi për autorizimin e parashikuar në pikën 1 është një operator ekonomik i autorizuar për thjeshtësi doganore.

3. Zyra doganore, në të cilën është depozituar deklaratata:

a) mbikëqyr vendosjen e mallrave nën regjimin doganor në fjalë;

b) kryen kontrollet doganore për verifikimin e deklaratës doganore, sipas përcaktimeve të shkronjave “a” dhe “b”, të nenit 169;

c) kur është e nevojshme, kërkon që zyra doganore, në të cilën janë paraqitur mallrat, të kryejë kontrollet doganore për verifikimin e deklaratës doganore, të përcaktuar në shkronjat “c” dhe “ç”, të nenit 169;

ç) kryen formalitetet për vjeljen e shumës së detyrimit të importit ose eksportit që i korrespondon çdo borxhi doganor.

4. Zyra doganore, në të cilën është depozituar deklaratata doganore dhe zyra doganore, në të cilën prezantohen mallrat, shkëmbejnë informacionin e nevojshëm për verifikimin e deklaratës doganore dhe për çlirimin e mallrave.

5. Zyra doganore, në të cilën janë paraqitur mallrat, pa cenuar kontrollet e saj të lidhura me mallrat e hyra në/ose të dala nga territori doganor i Republikës së

Shqipërisë, kryen kontrollet doganore, të përcaktuara në shkronjën “c”, të pikës 3, dhe i njofton zyrës doganore, në të cilën është depozituar deklarata doganore, rezultatet e kontrollit.

6. Zyra doganore, në të cilën depozitohet deklarata doganore, çliron mallrat në përputhje me nenin 175 dhe 176, duke marrë në konsideratë:

Fletore Zyrtare nr.134, datë 22 gusht 2014
6126

- a) rezultatet e kontrolleve të saj për verifikimin e deklaratës doganore;
- b) rezultatet e kontrolleve të kryera nga zyra doganore, në të cilën janë prezantuar mallrat, për verifikimin e deklaratës doganore dhe të kontrolleve që lidhen me mallrat e hyra në/ose të dalë nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

Neni 164

Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

- a) kushtet për dhënien e autorizimit të përcaktuar në paragrafin e parë, të pikës 1, të nenit 163;
- b) rregullat procedurale në lidhje me zhdoganimin e centralizuar, përfshirë dhe formalitetet doganore e kontrollet, sipas përcaktimeve të nenit 163;
- c) rregullat procedurale në lidhje me përjashtimin nga detyrimi i paraqitjes së mallrave, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 165, në kuadër të zhdogimit të centralizuar.